



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 12 dhjetor 2018, në orën:13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Adem Mikullovc, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaku, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje mungoi: Jasmina Zivkovic.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit: përfaqësues të Zyrës së BE, Ambasadës britanike, BIRN, KCSF, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draftligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua me një pikë shtesë të rendit të ditës, pikë e dytë e rendit të ditës:

**Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.06-P-087, dt. 3.12.2018, sipas së cilit ngarkohet komisioni të shqyrtojë Vendimin e Presidentit të Kosovës për Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, nr.06/L-043, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më dt. 7 nëntor 2018.**

## **2. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentit të Kosovës për Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare**

**Nait Hasani**, duke cekur pikën 84.6 të Kushtetutës së Kosovës, njoftoi komisionin për të drejtën e Presidentit, për të kthyer ligjin në rishqyrtim dhe mbi këtë të drejtë, Kryesia e Kuvendit, pas shqyrtimit të Vendimit të Presidentit, ka ngarkuar Komisionin funksional për shqyrtimin e vërejtjeve të Presidentit për ligjin, të cilin Kuvendi e ka miratuar më 7 nëntor 2018.

Ai tha se komisioni në fazën e amendamentimit ka marrë model ligjin e Gjermanisë, si shtet me infrastrukturë ligjore, sipas standardeve të BE-së. Gjithashtu, ai theksoi se nuk qëndron fakti se Kuvendi ka shkelur kushtetutshmërinë me miratimin e ligjit në fjalë.

**Shqipe Pantina**, pa dashur që të përsërisë propozimet që ajo ka pasur në procedurën e shqyrtimit të dytë, propozoi që komisioni të miratojë vërejtjet e Presidentit për ligjin dhe u deklarua se vota e saj është për miratimin e vërejtjeve.

**Valon Ramadani**, tha se, Presidenti nuk ka të drejtë të japë vërejtje në formë të amendamenteve për asnjë ligj. Ai u deklarua se do të abstenojë për Vendimin e Presidentit.

**Milaim Zeka**, tha se në emër të OJQ-ve në Kosovë, mëse 9000 biznese, banka, kolegje, veprojnë e funksionojnë pa i paguar taksë shtetit, prandaj nuk e përkrah Vendimin e Presidentit.

Komisioni, **me 5 vota “kundër”**- Nait Hasani, Imet Rrahmani, Milaim Zeka, Adem Mikullovcit dhe Albert Kinolli; **4 vota “për”** - Shqipe Pantina, Xhevahire Izmaqi, Arban Abrashi, Rasim Selmanaj dhe **1 “abstenim”** - Valon Ramadani, nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

Të mos miratohet Vendimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 23.11.2018, për nenet 3 (1.3), 15 (2), 16 (2), 17 (2), 18 (2), 37, 38 (3.4 dhe 5.4), 41 (1 (1.2), 2 dhe 3), 47 (2) të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

### **A R S Y E T I M**

Projektligji nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, është hartuar nga Ministria e Administratës Publike, ndërsa është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 09/20, datë 20.12.2017.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave për themelimin, regjistrimin, funksionimin, pezullimin, shuarjen, ndalimin e veprimit dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës. Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij projektligji është Ministria e Administratës Publike – Departamenti për Organizata Joqeveritare.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2018, e ka shqyrtuar dhe miratuar, në parim, si dhe ka kërkuar nga Kuvendi ta miratojë projektligjin.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më 15.3.2018, ka miratuar në parim projektligjin dhe ngarkoi si Komision funksional dhe raportues, Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Komisioni, më 18.4.2018, ka mbajtur dëgjim publik për Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, ku nga 65 organizata joqeveritare të ftuara, kanë marrë pjesë vetëm 10.

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, në mbledhjet e mbajtura, më 15.3, 18.4, 7.5, 28.5, 11.7, 25.7, 31.7 dhe 17.10.2018 dhe gjatë shqyrtimit të projektligjit ka nxjerrë 37 (tridhjetë e shtatë) amendamente.

Raporti me amendamente është proceduar për komisionet e përhershme, më 31.7.2018, që ta shqyrtojnë raportin, sipas kompetencës.

Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin dhe raportin me amendamente të komisionit. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, nuk kishin vërejtje apo komente në projektligj dhe amendamentet e Komisionit funksional.

Komisioni, më 17.10.2018, pas shqyrtimit nga komisionet e përhershme, e procedoi projektligjin për lexim të dytë.

Kuvendi, në seancën e tij të rregullt, më 7.11.2018, e radhiti si pikë 10 – Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, me 60 vota “për” 1, “kundër” dhe 2 “abstenime”.

Kryetari i Kuvendit, në bazë të nenit 80 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 61 (1) të Rregullores së Kuvendit, më 07 nëntor 2018, e ka nënshkruar ligjin e miratuar nga Kuvendi dhe e ka proceduar te Presidenti për shpallje.

Presidenti i Republikës së Kosovës, më 23.11.2018, në bazë të kompetencave të tij kushtetuese, ka marrë vendim për kthimin në rishqyrtim të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të miratuar nga Kuvendi, më 7.11.2018 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 19.11.2018.

Kryesia e Kuvendit, më 3.12.2018, ia procedoi komisionit, vendimin e Presidentit, për ta rishqyrtuar dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime, në afatin prej dyjavësh.

Në vendimin e tij, Presidenti i rekomandon Kuvendit si vijon:

Nenet 3 (1.3), 15 (2), 16 (2), 17 (2), 18 (2), 37, 38 (3.4 dhe 5.4), 41 (1 (1.2), 2 dhe 3), 47 (2) të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, nuk janë në pajtim me nenin

44 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare për lirinë e asociimit:

- 1.1. Përkufizimi i Organizatës Joqeveritare (OJQ) me dy kuptime, siç është bërë në Nenin 3 (1.2 dhe 1.3) të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, krijon paqartësi në zbatimin e dispozitave të ligjit dhe e bën të pazbatueshëm ligjin në fjalë.
- 1.2. Përcaktimi në nenin 15 (2), në Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, që akti i themelimit duhet të vërtetohet te noteri dhe se për personat juridikë, nuk është paraparë, që akti themelues të nënshkruhet edhe nga përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik, vështirëson lirinë e asociimit dhe është në kundërshtim me vlerat dhe frymën e Kushtetutës. Praktikrat e mira të regjistrimit të OJQ-së, promovojnë procedura të thjeshta, jo të vështira, të shpejta dhe pa pagesë.
- 1.3. Përcaktimi në nenin 16 (2) në Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, që shoqata duhet të themelohet nga të paktën 7 (shtatë) persona, e kufizon lirinë e asociimit dhe është në kundërshtim me vlerat dhe frymën e Kushtetutës, ngase shoqatat nënkuptojnë një grup vullnetar të personave me interesa, qëllime ose aktivitete të përbashkëta. Si rregull, grup nuk mund të konsiderohet vetëm një individ, por dy e më shumë, të cilët duhet të bashkohen për të avancuar interesat e tyre të përbashkëta. Për këtë arsye, praktikrat e mira kërkojnë që për themelimin e shoqatës duhet të jenë të paktën 2 themelues. Deri më tani, shoqatat në Republikën e Kosovës janë themeluar nga 3 (tre) e më shumë persona, në vend që të avancohet kjo praktikë e mirë, e ndërtuar prej vitesh, me këtë nen krijohen vështirësi për themelimin e shoqatave, për shkak të rritjes së numrit minimal të themelueseve.
- 1.4. Përcaktimi në nenin 17 (2), në Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, që fondacioni duhet të themelohet nga 3 (tre) ose më shumë persona, e kufizon lirinë e asociimit dhe është në kundërshtim me vlerat dhe frymën e Kushtetutës, ngase përderisa shoqatat mundësojnë bashkimin e personave, fondacionet janë formë e organizimit që karakterizohen nga fakti që nuk kanë anëtarë, mund të themelohen me kapital, me testament apo edhe me

lënie të trashëgimisë. Është i parëndësishëm numri i themelueseve të fondacioneve, përderisa kjo formë e organizimit nuk ka anëtarë. Me numrin e përcaktuar në këtë nen prej 3 (tre) ose më shumë personash, vetëm krijohen vështirësi për themelim.

- 1.5. Përcaktimi në nenin 18 (2), në Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, që instituti duhet të themelohet nga 3 (tre) ose më shumë persona, e kufizon lirinë e asociimit dhe është në kundërshtim me vlerat dhe frymën e Kushtetutës, ngase institutet janë formë e organizimit që karakterizohen nga fakti që nuk kanë anëtarë dhe baza e themelimit dhe funksionimit të instituteve është dija, shërbimi. Është i parëndësishëm numri i themelueseve të instituteve, përderisa kjo formë e organizimit nuk ka anëtarë. Me numrin e përcaktuar në këtë nen, prej 3 (tre) ose më shumë personash, vetëm krijohen vështirësi për themelim.
- 1.6. Neni 37 i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, anashkalon si aktivitet zhvillimin ekonomik, për të qenë si aktivitet parësor, për ato OJQ të regjistruara që mund të paraqesin kërkesë për status të përfitimit publik, njëkohësisht nuk parasheh që OJQ, me status për përfitim publik, të gëzojnë të drejtën për lirim nga tatimi dhe lehtësira tatimore dhe fiskale, që është esenciale që OJQ, me status për përfitim publik, t'u lehtësohet puna e tyre në interesin publik. Njëherësh, paragrafët 1 dhe 3 të nenit 37 të këtij ligji janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, derisa në paragrafin 1, përcaktohet se OJQ e regjistruar mund të paraqesë kërkesë për status të përfitimit publik, në paragrafin 3, përcaktohet se OJQ mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik me rastin e regjistrimit të OJQ-së.
- 1.7. Neni 38 (3.4) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, obligon të gjitha OJQ-të, që raportit vjetor t'i bashkëngjisin edhe raportin e auditorit, gjë që bien ndesh me paragrafin 8 të nenit 38 të këtij ligji, ku përcaktohet se cilat OJQ duhet t'i auditojnë pasqyrat financiare. Ndërsa, neni 38 (5.4) i ligjit, sikurse në nenin 37, anashkalon zhvillimin ekonomik, si aktivitet parësor.

- 1.8. Neni 41 (1.2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, përcakton se OJQ shuhet kur bëhet joaktive, sipas ligjit në fuqi, kjo dispozitë e tillë krijon pasiguri juridike në lirinë e asociimit dhe funksionimin e OJQ-ve, ngase nuk ka ndonjë përkufizim se çka është joaktive dhe krijon hapësirë për interpretim. Në nenin 41 (2 dhe 3) të ligjit, përcaktohet se në rast të shuarjes të OJQ-së, pasuria e mbetur pas shlyerjes së obligimeve të OJQ-së, i bartet OJQ-së tjetër të regjistruar në Republikën e Kosovës, ose institucioneve tjera me qëllime të njëjta apo të ngjashme, dilemat janë, cilat janë institucione tjera, përveç OJQ, që mund t'i bartet pasuria.
- 1.9. Neni 47 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, përcakton afatin për OJQ, për harmonizim të statuteve, por nuk u është lënë mundësia OJQ-ve që kanë qenë të themeluara si shoqata apo fondacione të kërkojnë ndryshimin e formës së organizimit, duke marrë parasysh nenin 19 të këtij ligji, që OJQ, përveç si shoqatë dhe fondacion, mund të organizohet edhe si institut.
2. Neni 44 (1) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garanton lirinë e asociimit dhe se liria e asociimit ndërthet të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë, pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktikat e mira ndërkombëtare, duhet që në Ligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të përcaktojë norma që do të garantojnë lirinë e asociimit, të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate, dhe të përcaktojë rregulla të përshtatshme dhe joburokratike për themelimin, regjistrimin, funksionimin, pezullimin, shuarjen, ndalimin e veprimit dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës.

## **PROPOZIMI PËR RISHQYRTIM**

4. Duke i marrë parasysh shqetësimet që janë shprehur në pjesën e arsytimit, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës:

4.1. Dispozita e nenit 3 (1.3) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Organizata Joqeveritare (OJQ) e vendit të huaj apo ndërkombëtare” – është një subjekt juridik jo për përfitim i themeluar jashtë Republikës së Kosovës”.*

4.2. Dispozita e Nenit 15 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Akti themelues nënshkruhet nga secili themelues. Për personat juridikë, akti themelues nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik”.*

4.3. Dispozita e nenit 16 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Shoqata themelohet nga tre (3) ose më shumë persona”.*

4.4. Dispozita e nenit 17 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Fondacioni themelohet nga një (1) ose më shumë persona”.*

4.5. Dispozita e nenit 18 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Instituti themelohet nga një (1) ose më shumë persona”.*

4.6. Në dispozitën e nenit 37, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata oqeveritare, të shtohet edhe aktiviteti: “zhvillim ekonomik”.

4.7. Dispozita e Nenit 37 (3) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“OJQ mund të paraqesë kërkesë për status për përfitim publik me rastin e regjistrimit të OJQ-së ose më vonë. Departamenti i lejon statusin e përfitimit publik OJQ-së, nëse dokumentet e regjistrimit dëshmojnë se qëllimet dhe veprimtaria e OJQ-së i plotëson kërkesat e këtij neni”.*

4.8. Dispozita e nenit 37 (4) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së për njohje të statusit për përfitim publik, të cilat gëzojnë të drejtën për lirim nga tatimi dhe lehtësira tatimore dhe fiskale, bëhet brenda afateve dhe sipas procedurave të përcaktuara me nenin 25 dhe 26 të këtij ligji”.*

- 4.9. Dispozita e nenit 38 (3.4) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“3.4. raporti i auditorit, siç kërkohet në paragrafin 8 të këtij neni”.*

- 4.10. Dispozita e nenit 38 (5.4) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“5.4. OJQ me status për përfitim publik në fushën e arsimit, shëndetësisë ose zhvillimit ekonomik dorëzon edhe informata shitesë për:...”*

- 4.11. Dispozita e nenit 41 (1 (1.2)) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“1.2. kur OJQ bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi...”*

- 4.12. Dispozita e nenit 41 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“Në rast të shuarjes të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësirat tatimore ose fiskale apo donacione publike, pasuria e mbetur pas shlyerjes së obligimeve të OJQ-së, i bartet OJQ-së tjetër të regjistruar në Republikën e Kosovës, me qëllime të njëjta apo të ngjashme”.*

- 4.13. Dispozita e nenit 41 (3) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“OJQ përcaktohet në bazë të statutit të OJQ-së së shuar, me vendim të organit më të lartë drejtues të OJQ-së së shuar, apo me vendim të gjykatës kur është rasti”.*

- 4.14. Dispozita e nenit 47 (2) i Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, të riformulohet si vijon:

*“OJQ harmonizon statutin e saj me këtë ligj brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas procedurave dhe afatit të përcaktuar me akt nënligjor, OJQ e regjistruar si shoqatë apo fondacion deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, mund të kërkojë nga Departamenti ndryshimin e formës së organizimit në Institut.”*



5. Shpallja e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, me përmbajtjen siç është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datën 7 nëntor 2018, do të rrezikonte lirinë e asociimit, të garantuar në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe si rrjedhojë është i dëmshëm për interesat legjitime të Republikës së Kosovës.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2018, shqyrtoi vendimin e Presidentit për kthimin e ligjit dhe me 5 vota “kundër”, 4 vota “për” dhe 1 “abstenim”, vendosi si në dispozitiv të këtij rekomandimi.

### **3. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draftligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave**

**Nait Hasani**, njoftoi komisionin për propozim-ndryshimet shtesë për Projektligjin për KPM-në, nga KPM-ja.

**Shqipe Pantina**, propozoi që para se të hartohen propozim-ndryshimet, të ftohen të gjitha grupet e interesit që për funksionimin e tyre e kanë bazë ligjin për KPM-në.

**Xhevahire Izmaku**, propozoi që paraprakisht gjatë hartimit të propozim-ndryshimeve të konsultohen edhe me KPM-në.

**Konstatim:** Propozim-ndryshimet shtesë për Projektligjin për KPM-në u miratuan nga komisioni.

### **4. Të ndryshme**

**Valon Ramadani**, propozoi për mbledhjen e radhës të ftohet Bordi i RTK-së, për të njoftuar komisionin, lidhur me anulimin e konkursit për përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.

**Shqipe Pantina**, njoftoi komisionin se me Projektligjin për buxhetin për vitin 2019, nuk është ndarë buxhet për digjitalizimin dhe propozoi që komisioni të hartojë propozim-amendament për ndarje të buxhetit për digjitalizimin dhe të ftohet ministri i zhvillimit ekonomik, për të njoftuar komisionin për çështjen e digjitalizimit.

**Konstatim:** të dy propozimet u miratuan nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:20.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Nait Hasani**